


AKT THEMELIMI

I SHOQERISE TREGTARE "ERALD" SH.P.K. ME SELI NE QEREKE TE KRUIES



Sot, me date 07 tetor 1997, une ARJAN MUJA, i biri i Ganiut dhe Sermes, i lindur ne Qereke te Krujes, me 1.05.1973, banues ne Qereke te Krujes, shtetas shqiptar, me deshiren time, meqenese i plotesoj kushtet e parashikuara nga Ligji Nr.7512, date 10.08.1991 "Per Sanksionimin dhe Mbrojtjen e Prones Private, te Nismes se Lire, te Veprimtarive Private te Pavarura dhe Privatizimit", Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Private" dhe Ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Private", mora vendimin qe te krijoj si "Ortak i Vetem" Shoqerine Private me Pergjegjesi te Kufizuar "ERALD" Sh.p.k.

NENI 1

Shoqeria Tregtare "ERALD" SH.P.K. themelohet si shoqeri shqiptare. Selia e saj do te jete ne qytetin e Krujes, fshati Qereke.

NENI 2


Veprimtaria e shoqerise regullohet nga normat juridike te ketij Akti Themelimi, Statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar.

NENI 3

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, qe perbehet nga kontributi ne leke i ortakut te vetem.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- 
- Tregtim artikujsh te ndryshem industriale, vendi e importi, me shumice e pakice, import - eksport.
 - Tregtim artikujsh te ndryshem ushqimore, import-eksport.
 - Tregtim pijesh alkoolike, me shumice e pakice, import-eksport.
 - Tregtim duhan cigare, me shumice e pakice, import-eksport.
 - Tregtim karburantesh te ndryshme, vajrash lubrifikante, te çdo tipi e lloji.
 - Tregtim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi si dhe pjesesh kembimi per to.
 - Tregtim makinerish te ndryshme e pajisjesh industriale e bujqesore dhe venie e tyre ne shfrytezim.
 - Tregtim pajisjesh elektro-shtepijake, elektrike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati etj.
 - Tregtim materialesh ndertimi e lendesh te para, import-eksport.

- Tregtim pleherash e prodhimesh te tjera kimike.
- Tregtim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Tregtim dhe prodhim farerash, lulesh e prodhimesh te tjera kopshtarije.
- Tregtim bimesh medicinale e etero-vajore.
- Transport mallrash e pasagjeresh.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative etj.
- Shfrytezim, Prodhim, Perpunim, Tregtim dhe Transport i lendes drusore, te paperpunuar dhe te perpunuar, si pishe, ah, lis etj. si dhe druve te zjarrit.
- Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi etj.
- Gatistim i lendes drusore (Prodhim lende te sharruar).
- Ngritje linjash telefonike e telegrafike.
- Investime ne ndertim, industri e bujqesi.

NENI 5

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit.

Ortaku i vetem mund ta zgjase afatin e veprimtarise se shoqerise pas plotesimit te afatit.

Ortaku i vetem mund te kerkoje prishjen e shoqerise perpara perfundimit te afatit te percaktuar me siper, per arsye te perligjura.

NENI 6

Investimet dhe veprimtaria e shoqerise gezon mbrojtjen e shtetit, i cili krijon kushte te njejta me te gjitha subjektet e tjere private e shteterore.

Shoqeria perballon detyrimet qe krijon ndaj te treteve vetem me kapitalet e saj.

NENI 7

Fitimi i realizuar nga shoqeria, pasi zbriten shpenzimet e fondet e ndryshme, sipas llogarive, disponohet sipas deshires se ortakut te vetem.

NENI 8

Administrator i shoqerise do te jete z. ARJAN MUJA.

NENI 9

Aktiviteti i shoqerise do t'i permbahet Statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoje dispozitat ligjore qe jane ne fuqi, si dhe ato qe mund te dalin me vone, per ushtrimin e veprimtarive private te shoqerive tregtare Sh.p.k.

NENI 10

Ky Akt Themelimi u perpilua ne tre kopje, te cilat kane vlere te barabarte mes tyre.

ORTAKU I VETEM:


ARJAN MOJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 2320 Rep.
Nr. 587 Kol.

VERTETIM

Sot, me date 07.10. 1997 (nentedhjete e shtate), para meje noterit u paraqit personalisht Ortaku i vetem i Shoqerise Tregtare "ERALD" Sh.p.k., per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi i tij personal NF Nr.303255, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se kete Akt Themelimi te shoqerise, te redaktuar jashte kesaj zyre e ka gjetur sipas vullnetit te tij te lire dhe te plote dhe, pasi ai e nenshkruan, une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI



* NOTERE
ZEQINE S...
TIRANE



S T A T U T I

I SHOQERISE TREGTARE "ERALD" SH.P.K. ME SELI NE QEREKE TE KRUJES



I redaktuar sot, me date 07 tetor 1997, me kerkesen e Ortakut te Vetem: Arjan MUJA, i biri i Ganiut dhe Sermes, i lindur me 1.05.1973, ne Qereke te Krujes dhe banues po aty, shtetas shqiptar, i cili deklaroi se Shoqeria e themeluar prej tij do te funksionojë ne baze te ketij Statuti:

I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria Tregtare "ERALD" SH.P.K. rregullon poziten juridike, organet e saj, llojin e shoqerise, kohen e veprimtarise, marredheniet e te punesuarve etj. ne baze te Ligji Nr.7512, date 10.08.1991 "Per Sanksionimin dhe Mbrojtjen e Prones Private, te Nismes se Lire, te Veprimtarive Private te Pavarura dhe Privatizimit", Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Private" dhe Ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhën Respektuar nga Shoqerite Private".

NENI 2

Shoqeria ka seline e saj ne fshatin Qereke, Kruje, dhe kryen veprimtari ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise. Shoqeria mund te krijojë agjensi, dege e filiale te tjera ne Shqiperi e jashte saj, duke respektuar ligjet e vendit ne te cilin ato ngrihen.

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- Tregtim artikujsh te ndryshem industriale, vendi e importi, me shumice e pakice, import - eksport.
- Tregtim artikujsh te ndryshem ushqimore, import-eksport.
- Tregtim pijesh alkoolike, me shumice e pakice, import-eksport.
- Tregtim duhan cigare, me shumice e pakice, import-eksport.
- Tregtim karburantesh te ndryshme, vajrash lubrifikante, te çdo tipi e lloji.
- Tregtim automjetesh te çdo lloji, marke e tonazhi si dhe pjesesh kembimi per to.
- Tregtim makinerish te ndryshme e pajisjesh industriale e bujqesore dhe venie e tyre ne shfrytezim.
- Tregtim pajisjesh elektro-shtepijake, elektrike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati etj.
- Tregtim materialesh ndertimi e lendesh te para, import-eksport.
- Tregtim pleherash e prodhimesh te tjera kimike.



- Tregtim prodhimesh kozmetike e estetike.
 - Tregtim dhe prodhim farerash, lulesh e prodhimesh te tjera kopshtarije.
 - Tregtim bimesh medicinale e etero-vajore.
 - Transport mallrash e pasagjeresh.
 - Hapje dhe shfrytezim hotelesh, baresh, restorantesh, diskotekash, qendrash pushimi e kurative etj.
 - Shfrytezim, Prodhim, Perpunim, Tregtim dhe Transport i lendes drusore, te paperpunuar dhe te perpunuar, si pishe, ah, lis etj. si dhe druve te zjarrit.
 - Tregtim prodhimesh te ndryshme druri, mobilje, orendi etj.
 - Gatrim i lendes drusore (Prodhim lende te sharruar).
 - Ngritje linjash telefonike e telegrafike.
 - Investime ne ndertim, industri e bujqesi.
- Shoqeria ka te drejte te shtoje objektin e veprimtarise se saj me deshiren e Ortakut te Vetem.

NENI 4

Shoqeria eshte person juridik privat shqiptar. Ajo do te paraqitet ne qarkullimin civil me emertimin "ERALD" SH.P.K.

NENI 5

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 (njqind mije) leke, qe perbehet nga kontributi ne leke i ortakut te vetem.

NENI 6

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit.
Ortaku i vetem mund ta zgjase afatin e veprimtarise se shoqerise pas plotesimit te afatit.

NENI 7

Shoqeria udhehiqet nga parimet e ekonomise se tregut, duke pasur si qellim fitimin. Ajo respekton parimin e llogarise dhe reciprocitetit.

NENI 8

Shoqeria eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar. Ajo mban pergjegjesi per humbjet deri ne sasine e kapitalit te investuar.

II. KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE

NENI 9

Veprimtaria dhe funksionimi i shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise se tegut dhe ndertohet mbi parimin e llogarise, duke u pasqyruar ne bilancet e veta.

NENI 10

Kapitali fillestar i investuar nga ortakut i vetem perben bazen e krijimit te fondit themelor dhe mjeteve te xhiros.

NENI 11

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera financimi per te perballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare per shlyerjen e detyrimeve gjate veprimtarise se saj.

NENI 12

Shoqeria mund te bleje pasuri te tjera, te cilat regjistrohen ne emer te saj. Shoqeria mund te lere peng pjese te kapitalit te saj themelor. Kur keto pjese i nenshtrohen shitjes se detyruar, pengmarresi do te pranohet si person qe i transferohet kapitali, pervec rastit kur shoqeria preferon t'i ribleje pjeset.

NENI 13

Kapitali themelor mund te zmadhohet ose te zvogelohet, sipas vendimeve qe merr ortakut i vetem.

Zvogelimi i kapitalit nuk duhet te demtojte kreditorët dhe as te krijojë pasiguri tek ata qe kane dhene kredi para publikimit te zvogelimit te kapitalit. Ne te kunderten, Gjykata e konsideron te pavlefshem kete vendim mbi kerkesen e kreditorëve.

NENI 14

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Forma e bilancit percaktohet nga administratori, ne harmoni me format e bilanceve te vendosura ne Republiken e Shqiperise.

NENI 15

Plani financiar parashikon aktivin dhe pasivin e aktivitetit ekonomik te shoqerise te shprehur ne leke ose ne valute te konvertueshme. Llogaria ekonomike do te mbahet ne Shqiperi.

III. ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 16



Shoqeria "ERALD" Sh.p.k. është prone e z. Arjan MUJA, themelues i saj. Ai merr vendime në zbatim të ligjeve në fuqi dhe sipas këtij statuti, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri.

NENI 17

Administratori ka këto kompetenca:

- Përfaqëson shoqërinë në organet e pushtetit, të administratës ose ato gjyqësore, si dhe në marrëdhëniet me të tretet e zgjidh mosmarrëveshje.
- Përgatit raportin tremujor e vjetor të administrimit dhe ia paraqet Ortakut të Vetem.
- Siguron zbatimin e vendimeve që merr Ortaku i Vetem.
- I paraqet Ortakut të Vetem propozime konkrete për ndryshimin e kapitalit themelor.
- I propozon Ortakut të Vetem mundësinë e krijimit të filialeve e degeve të shoqërisë.
- Propozon krijimin e organeve administrative për përmirësimin e punës drejtuese e kontrolluese.
- Kërkon nga Ortaku i Vetem ose nxjerr akte që rregullojnë marrëdhëniet e punës.
- Përzgjedh e i propozon Ortakut të Vetem eksperte kontabel e likuidatorin.
- Nenshkruan për llogari të shoqërisë kontrata, përveç atyre që Ortaku i Vetem i gjykon t'i lidhë vete.
- Lidh kontratën individuale dhe kolektive të punës.
- Organizon e drejton veprimtarinë e shoqërisë.
- Nese do të emerohen me tepër se një administratorë, secili prej tyre nuk mban përgjegjësi për veprimet e kryera nga tjetri.
- Administratorët përgjigjen për të gjitha veprimet para Ortakut të Vetem.

Administrator i Shoqërisë "ERALD" SH.P.K. do të jetë z.Arjan MUJA.

NENI 18

Administratorët përgjigjen individualisht për demet që i vijnë shoqërisë nga veprimtaria e tyre e fajshme gjatë administrimit.

NENI 19

Shoqëria cakton ekspert kontabel për çdo vit financiar. Caktimin e tyre e bën Ortaku i Vetem.

Ekspertët kontabel mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullit dhe shqyrtimin e llogarive. Ata përgjigjen për demet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i gabuar i tyre.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit kontabel ortaku i Vetem, administratorët, personat që janë gjini e krushqi me ta deri në shkallën e katert. Po ashtu, nuk mund ta kryejnë këto detyra përgjegjësit e degeve, filialeve e agjensive.



IV. MARREDHENIET E PUNES

NENI 20



Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar te punes.

Punesimi ne shoqeri realizohet me ane te kontrates individuale te punes midis shoqerise dhe te punesuarit.

Marredheniet midis shoqerise dhe sindikates rregullohen nepermjet kontrates kolektive te punes.

NENI 21

Kontrata individuale e punes rregullon keto marredhenie:

- marrja ne pune; kushtet e te punesuarit per t'u marre ne pune.
- lloji i punes qe do te kryeje i punesuari, profesionet ndihmese.
- koha e punes ditore e javore; pushimi ditor e javor.
- shperblimi per kohen e punes, per periudhen jashte kohes normale te punes, per punen e nates e ne ditet e pushimit e festave.
- shperblimi i punonjesve per pune te dalluar.
- pergjegjesite e paleve per mosrespektimin e kontrates.

NENI 22

Te punesuarit dhe punonjesit drejtues administrative jane pergjegjes ndaj shoqerise per demet qe i shkaktojne me faj dhe pergjigjen para saj civilisht.

V. MBYLLJA E SHOQERISE. LIKUIDIMI.

NENI 23

Veprimtaria e shoqerise mund te nderpritet para afatit te parashikuar ne Aktin e Themelimit ne keto raste:

- kur shoqeria nuk rezulton kontabel gjate tre viteve te fundit rradhazi.
- kur per kete vendos gjykata kompetente.



NENI 24

Kur vendoset shkrirja e shoqerise, mbi propozimin e administratorit, ortaku i vetem cakton nje ose me shume likuidatore, qe realizojne likuidimin e saj. Shoqeria gjate likuidimit mban anash emertimit edhe shenimin "Shoqeri ne likuidim e siper".

Me miratimin e likuidimit shoqeria i jep fund veprimtarise.

NENI 25

Ortaku i vetem vendos mbi rregullshmerine e likuidimit, per bilancin e likuidimit e heqjen e mandatit te likuidatorit.

Kur ortaku i vetem, pa shkaqe te arsyeshme, nuk vendos per aktet e mesiperme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund te kerkoje nga gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes se likuidimit, se bashku me llogarite perkatese perfundimtare, depozitohen ne Regjistrin Tregtar.

Mbas mbylljes se likuidimit e depozitimit te dokumentacionit ne Regjistrin Tregtar, shoqeria çregjistrohet prej tij.

VI. DISPOZITA TE FUNDIT


NENI 26

Nepunesit, te zgjedhurit nga ortaku i vetem e personat qe punojne per llogari te saj, mbajne pergjegjesi penale e civile, sipas neneve 296, 297, 300 dhe 301 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare", kur, me dashje, shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojne humbje shoqerise ose, me ndergjegje paraqesin te dhena te paverteta ekonomike.

NENI 27

Statuti hyn ne fuqi menjehere pas miratimit dhe regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

ORTAKU I VETEM:



Arjan MUSA

